

VENDIM
Nr. 22, datë 19.2.2024

**MBI ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES NDËRMJET SHOQËRISË “NTSP” SHPK
DHE SHOQËRIVE “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” SHA DHE “OPERATORI I
SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” SHA**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, geramat “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2, 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 15 dhe 23 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 3.9.2016, nenit 11, pika 4 të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016; në mbledhjen e tij të datës 19.2.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 4/1 prot., datë 7.2.2024, të grupit të punës, “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërive ‘Tren Sun System’ sh.p.k., ‘Sun Beat System’ sh.p.k., ‘NTSP’ sh.p.k., ‘Korça Photovoltaic Park’ sh.p.k., dhe shoqërive ‘Furnizuesi i Tregut të Lirë’ sh.a. dhe ‘Operatori i Sistemit të Shpërndarjes’ sh.a.

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 319, datë 8.11.2023, ndër të tjera vendosi: (1) Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëritë “Tren Sun System” sh.p.k., “Sun Beat System” sh.p.k., “NTSP” sh.p.k., “Korça Photovoltaic Park” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërive dhe shoqërisë “FTL”, duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

- Shoqëria “NTSP” sh.p.k. është licencuar nga ERE për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe mban licencën nr. 516, seria P22, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 21.7.2022. Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1921/3 prot., datë 23.10.2023, ndër të tjera kërkon: “njohjen dhe blerjen e energjisë së prodhuar për periudhën 28.7.2022 deri më 8.11.2022... trajtimin e mëtejshëm të kërkesës sonë nga institucioni juaj”.

- Shoqëria FTL sh.a. është licencuar nga ERE në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike dhe mban licencën nr. 423, seria F18/F23, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 199, datë 3.9.2018, dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 121, datë 4.4.2023. Shoqëria FTL sh.a., nëpërmjet shkresave si vijon, ka parashtruar:

- Me shkresën me nr. 2834/3 prot., datë 11.10.2023 drejtuar shoqërisë “NTSP” sh.p.k., ka parashtruar si vijon:“për periudhën e kërkuar 28.7.2022–8.11.2022, shoqëria FTL sh.a. nuk ka pasur kontratë shitblerje të energjisë elektrike me shoqërinë “NTSP” sh.p.k. Kontrata ndërmjet “NTSP” sh.p.k. dhe “FTL” sh.a. me nr. 575/2 prot., për shitblerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga centrali fotovoltaiik, është lidhur me datë 28.4.2023, dhe ka hyrë në fuqi më datë 2.5.2023, datë e cila korrespondon me fillimin e operimit/lëvrimin të energjisë elektrike, siç përcaktuar në Aneksin e kontratës”.

- Në datën 26.9.2023, ERE organizoi një seancë dëgjimore, mes përfaqësuesve të shoqërive “Tren Sun System” sh.p.k., “Sun Beat System” sh.p.k., “NTSP” sh.p.k., “Korça Photovoltaic Park” sh.p.k., si dhe përfaqësuesve të shoqërive OSSH sh.a., FTL sh.a. Objekti i kësaj seance dëgjimore konsistonte në trajtimin e problematikës së ngritur nga shoqëritë “Tren Sun System” sh.p.k., “Sun Beat System” sh.p.k., “NTSP” sh.p.k., “Korça Photovoltaic Park” sh.p.k., mbi prodhimin e lëvruar dhe të pa kontraktuar nga njësitë gjeneruese fotovoltaike në zotërim të këtyre shoqërive.

- Më datë 21.11.2023, ERE organizoi përsëri një seancë të dytë dëgjimore, mes përfaqësuesve të shoqërive të mësipërme dhe të shoqërive OST sh.a., OSSH sh.a., FTL sh.a. si dhe përfaqësuesve të ERE-

s. Në këtë seancë dëgjimore FTL sh.a. parashtroi se vlerëson që nuk është palë në këtë mosmarrëveshje, dhe se kjo mosmarrëveshje është ndërmjet shoqërive prodhuese fotovoltaike “Tren Sun System” sh.p.k., “Sun Beat System” sh.p.k., “NTSP” sh.p.k., “Korça Photovoltaic Park” sh.p.k., dhe shoqërisë OSSH sh.a.

- Në të njëjtën kohë ERE bëri me dije se të gjithë pjesëmarrësit në seancën dëgjimore janë thirrur duke marrë në konsideratë detyrimet ligjore që ka secila shoqëri/pjesëmarrëse në seancë. Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” ndër të tjera në nenin 12, pika 2 dhe pika 3, përcakton se: 2. Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE. Shoqëria publike e prodhimit ka të drejtë të lidhë kontratë blerjeje të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme që shërbejnë për diversifikimin e prodhimit e saj. 3. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, deri në krijimin e operatorit të energjisë së rinovueshme dhe krijimin e tregut të ditës në avancë, do ta tregtojë këtë energji për mbulimin e humbjeve të “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes”, me të njëjtin çmim me të cilin e blen këtë energji nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, deri në përfundimin e kontratave të shitblerjes së energjisë.

- Në seancë, shoqëria OST sh.a. bëri me dije se aktrakordimet për energjinë elektrike të prodhuar ku përfshihet edhe energjia elektrike e prodhuar nga prodhuesit me përparësi nënshkruhen ndërmjet shoqërive OST sh.a., FSHU sh.a dhe FTL sh.a /OSHEE Group sh.a., për energjinë elektrike të transmetuar nga OST sh.a. për llogari të FSHU sh.a. dhe FTL sh.a/OSHEE Group sh.a.

- Në këto rrethana, vlerësohet se shoqëria FTL sh.a. është palë në këtë mosmarrëveshje duke marrë në konsideratë përcaktimet e sipërcituara të VKM-së nr. 456/2022, si dhe faktin që është pjesëmarrëse në aktrakordimet për energjinë elektrike të prodhuar dhe të rakorduar ndërmjet palëve. Gjithashtu, duke qenë se pika 3 e VKM-së nr. 456/2022, përcakton se FTL sh.a. e tregon këtë energji për mbulimin e humbjeve të “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes”, me të njëjtin çmim me të cilin e blen këtë energji nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, edhe OSSH sh.a. është palë në shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshje.

- Në vijim të detyrave të lëna në seancën dëgjimore të datës 21.11.2023, shoqëria FTL sh.a., me shkresën nr. 3408/1 prot., datë 21.11.2023, ka përcjellë në ERE: (i) kontratat për secilën shoqëri; (ii) procesverbalet e verifikimit fillestar të sistemit të matjes për secilën shoqëri; (iii) komunikimet shkresore ndërmjet palëve; (iv) kërkesat e shoqërive “Tren Sun System” sh.p.k., “Sun Beat System” sh.p.k., “NTSP” sh.p.k., “Korça Photovoltaic Park” sh.p.k. drejtuar shoqërisë FTL sh.a. lidhur me prodhimin e munguar dhe të pa kontraktuar nga njësitë gjeneruese fotovoltaike respektive; dhe (v) aktrakordim trepalësh për muajt korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor – viti 2022.

- Rezulton se nga procesverbalet e instalimit/verifikimit të sistemit të matjes të vënë në dispozicion nga FTL sh.a. dhe shoqëritë prodhuese janë hartuar për sistemin e matjes për shoqëritë ankuese dhe janë përgatitur nga OSSH sh.a./OSHEE Group sh.a. për secilën shoqëri me numër serial unik dhe janë të datës 28.7.2022.

- Në vijim nga vlerësimi periodik i sistemit të matjes në procesverbalet e datës 8.9.2022 nga ku rezulton se: (a) procesverbali i hartuar për sistemin e matjes për shoqërinë “NTSP” sh.p.k., i përgatitur nga OSSH sh.a./OSHEE Group sh.a. ka numrin serial 5176619 dhe është i datës 8.9.2022. Në këtë procesverbal evidentohet se është vendosur karta sim për transmetimin e të dhënave on Line, ku ndër të tjera, evidentohet se matësi rezultoi i rregullt.

- Vlerësimet në sistemin e matjes të rakorduara nga procesverbalet e mbajtura në datat: (i) 1.10.2022; (ii) 1.12.2022; dhe (iii) 1.1.2023, për secilën shoqëri me numër serial unik evidentohet se: nga verifikimi i

kryer u konstatua se matësi është brenda kushteve teknike. Në procesverbalet e sipërcituara evidentohet, se: (i) për shoqërinë “NTSP” sh.p.k. numri i serisë së matësit është 217325920.

- Shoqëria FTL sh.a., ka përcjellë në ERE në dokumentacionin përkatës dhe procesverbalet e sistemit të matjes ndërmjet FTL sh.a./OSHEE Group sh.a. dhe shoqërive “Tren Sun System” sh.p.k., “Sun Beat System” sh.p.k., “NTSP” sh.p.k., “Korça Photovoltaic Park” sh.p.k. të cilat janë nënshkruar në datën 2.5.2023.

- Ndërkohë dokumentacioni i përcjellë nga shoqëria OSSH sh.a. me shkresës nr. 12149/3 prot., datë 28.12.2023, protokolluar në ERE me nr. 4 prot., datë 3.1.2024, përfshinë për secilën shoqëri ankuese: (i) formular prezantimi të kërkesës, ankesës; (ii) procesverbalet e mbajtura nga OSSH sh.a./OSHEE Group sh.a.; (iii) parametrat e konfigurimit; dhe (iv) urdhrat e punës.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 76 “Matja e energjisë elektrike”, pika 1, përcakton se: operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes janë përgjegjës për veprimtarinë matëse dhe shërbimin e leximit të matësve në rrjetet e tyre përkatëse.

- Shoqëria OSSH sh.a. në përputhje me këto përcaktime ligjore bazuar në procesverbalet e mbajtura për shoqëritë “Tren Sun System” sh.p.k., “Sun Beat System” sh.p.k., “NTSP” sh.p.k., “Korça Photovoltaic Park” sh.p.k., më datë 28.7.2022, ka vulosur sistemin matës të shoqërive dhe në rubrikën me emërtesën “shënime/veprimi i kryer” të procesverbaleve respektive ka shënuar: Në panel u vulosën transformatorët e rrymës, transformatorët e tensionit, morseteria e matësit, boksi i matësit.

- Rezulton se në procesverbalet e mbajtura nga OSSH sh.a./OSHEE Group sh.a., sistemi i matjes së energjisë elektrike në të katërta shoqëritë prodhuese është instaluar më datë 28.7.2022 dhe në mënyrë periodike është lexuar nga shoqëria OSSH sh.a. energjia elektrike e prodhuar dhe e regjistruar në këta matës. Gjithashtu, në këto procesverbale është shënuar në çdo rast se: Nga verifikimi i kryer u konstatua se matësi është brenda kushteve teknike. Këto elemente të cilat tregojnë se sistemi i matjes ka qenë funksional dhe brenda kushteve teknike.

- Për rrjedhojë rezulton se energjia elektrike e prodhuar për periudhën 28.7.2022 deri më 8.11.2022 është e matur në një sistem matje i cili në çdo verifikim të bërë nga operatori i rrjetit përkatës (OSSH sh.a.) rezulton se është brenda kushteve teknike.

- Në procesverbalet e mbajtura më datë 8.9.2022 nga OSSH sh.a. gjithashtu përcaktimet për të katërta shoqëritë janë të njëjta, ku evidentohet se para hapjes së vulave: matësi në rregull, në ekran displei i matësit diagrami rezulton në krah të kundërt energjia e prodhuar shihet si e konsumuar.

- Në rubrikën shënime veprimi i kryer: U hap boksi dhe morseteria e matësit për t’ju vendosur karta sim për transmetimin on line të të dhënave. Iu bë dhe diagrami vektorial ku matësi rezultoi i rregullt. Matësit iu bë ndryshimi i koeficientit, nga koeficient i jashtëm në koeficient të brendshëm nga firma e autorizuar. Për efekt të ndryshimit të koeficientit matësi u zerua, gjithashtu, janë bërë dhe sistemimet e diagramit në drejtimin e duhur. Në këto procesverbale është evidentuar edhe energjia elektrike e prodhuar dhe e konsumuar. Sa konstatohet nga procesverbalet e mbajtura ndërmjet palëve të sipërcituara, të katërta shoqëritë prodhuese kanë prodhuar një sasi energjie elektrike, fakt që vërtetohet dhe nga të dhënat e matësve të instaluar.

- Energjia e prodhuar nga shoqëria “NTSP” sh.p.k., sikurse evidentohet në matësit e instaluar është lëvruar në sistemin e shpërndarjes duke filluar nga data 28.7.2022 deri më 8.11.2022 pasi këto njësi gjeneruese janë të lidhura në rrjetin 35 kV të energjisë elektrike që zotërohet dhe operohet nga shoqëria OSSH sh.a., kjo dhe për faktin se energjia elektrike as nuk depozitohet apo tjetërsohet.

- Këto parashtrime të OSSH sh.a. vërtetohen edhe nga shoqëria OST sh.a. me shkresën nr. 5980/2 prot., të protokolluar në ERE me nr. 1919/15 prot., datë 6.12.2023, ku në tabelën përkatëse në të cilën evidentohet se transmetimi i të dhënave on line në platformën e marrjes së OST sh.a. për të katërta shoqëritë prodhuese ka filluar më datë 8.9.2022 kur është instaluar edhe karta sim për transmetimin e të dhënave on line të matjes.

- Rezulton se kontratat për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë FTL sh.a. dhe shoqërive prodhuese me përparësi të energjisë elektrike janë nënshkruar si më poshtë vijon:

a) Kontrata ndërmjet FTL sh.a. dhe shoqërisë “NTSP” sh.p.k. me nr. 575/2 prot. Në këtë kontratë evidentohet se shoqëria “NTSP” sh.p.k. dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kanë lidhur kontratën për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fototvoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw me nr. 3006 rep., nr. 1253 kol., datë 7.6.2022.

- Aktet ligjore përcaktojnë se energjia elektrike nga prodhuesit me përparësi nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2 mw, me çmimin e miratuar nga ERE për vitin respektiv të nënshkrimit të kontratës/autorizimit nga ministria përkatëse. Rezulton se shoqëria “NTSP” sh.p.k., është autorizuar nga MIE në vitin 2022. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 166, datë 28.6.2022, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2 mw për vitin 2022”, ka përcaktuar çmimin = 97.21 euro/MWh.

- Në lidhje me aktrakordimt gjatë periudhës së mosmarrëveshjes, rezulton se shoqëria OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 5980 prot., të protokolluar në ERE me nr. 1919/15 prot., datë 6.12.2023, si dhe nëpërmjet e-mail-it të datës 6.12.2023, ka përcjellë në ERE informacionin e kërkuar të cilin e disponon.

- Gjithashtu, FTL sh.a. nëpërmjet shkresave me nr. 3408/2 prot., datë 21.11.2023, nr. 3408/1 prot., datë 21.11.2023, nr. 3368/1 prot., datë 22.11.2023, si dhe nr. 3408/5 prot., datë 24.11.2023, ka përcjellë dokumentacionin përkatës.

- Të dyja shoqëritë kanë përcjellë aktrakordimet të cilat mbahen periodikisht me bazë mujore ndërmjet shoqërive OST sh.a., FSHU sh.a dhe FTL sh.a./OSHEE Group sh.a., për energjinë elektrike të transmetuar nga OST sh.a. për llogari të FSHU sh.a dhe FTL sh.a./OSHEE Group sh.a.

- Këto aktrakordime janë mbajtur ndërmjet palëve për periudhat: (i) 1–30 shtator 2022; (ii) 1–31 tetor 2022; (iii) 1–30 nëntor 2022; dhe (iv) aktrakordim i korigjuar ndërmjet OST sh.a., FSHU sh.a dhe FTL sh.a /OSHEE Group sh.a., për energjinë elektrike të transmetuar nga OST sh.a. për llogari të FSHU sh.a. dhe FTL sh.a /OSHEE Group sh.a., duke reflektuar vlerat e energjisë së prodhuar nga gjeneruesit në treg të lirë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes për periudhën 1–30 nëntor 2022.

- Shoqëria OST sh.a. nëpërmjet komunikimit me e-mail më datë 6.12.2023 (dërguar më datë 6.12.2023, 3:27 PM) ka përcjellë në ERE komunikimet me e-mail të realizuara nga OST sh.a. me bazë ditore nëpërmjet të cilave OST sh.a. njofton rregullisht çdo ditë përfaqësuesit e OSHEE Group sh.a./OSSH sh.a./FTL sh.a./FSHU sh.a. në të cilat evidentohet dhe prodhimi i energjisë elektrike i realizuar me bazë ditore përfshirë subjektin “NTSP” sh.p.k.

- Shoqëria OST sh.a. ka realizuar procesin e matjes së energjisë elektrike të subjektit “NTSP” sh.p.k., në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar, neni 76, “Matja e energjisë elektrike”, pika 1, citohet, se: “Operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes janë përgjegjës për veprimtarinë matëse dhe shërbimin e leximit të matësve të tyre përkatës”.

- Në zbatim të shkresës së dërguar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë me nr. 2510 prot., datë 8.4.2016, ku shprehet se: “të gjitha pikat e lidhura në tension 35 kV do të integrohen përkohësisht në platformën e menaxhimit të matjeve në OST sh.a.”.

- Pikat e matjes së subjekteve prodhuese për shoqërinë “NTSP” sh.p.k., janë lidhur në rrjetin 35 kV, të cilat janë konfiguruar në platformën e menaxhimit të matjes në OST sh.a. më datë 8.9.2022, në përputhje me përcaktimet e sipërcituara.

- Shkresa dhe dokumentacioni i dërguar me e-mail nga shoqëria OST sh.a., të lartë përmendura faktojnë që palët kanë pranuar energjinë elektrike të gjeneruar nga subjekti “NTSP” sh.p.k., për periudhën 28.7.2022 deri më 8.11.2022.

- Nisur nga sa përshkruar më lartë, palët nga procesverbalet e përcjella mbi sistemin e matjes, aktrakordimet e nënshkruara ndërmjet tyre, dhe evidentimi me e-mail të sasive të prodhuara të energjisë elektrike, kanë pranuar me veprime konkludente kontratën si veprim juridik, nëpërmjet shprehjes së

vullnetit të tyre, bazuar në nenin 80¹ të Kodit Civil, i cili parashikon se: veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit, i cili sipas arsytimit të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë me nr. 11243-01443-00-2008 i regi. themeltar nr. 00-2013-763 i vendimit (172), ku parashikohet se: "...me shprehjen "shfaqje tjetër e padyshimtë e vullnetit", do të kuptojmë pikërisht, shfaqjen e vullnetit me veprime konkludente ose me heshtje. Një gjë e tillë parashikohet qartë dhe në nenet 669 dhe 676 të K.Civil, të cilat nuk bëjnë gjë tjetër, veçse plotësojnë kuptimin e nenit 80 të K.Civil."

- Në këtë kuptim dhe në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë, fakti që sipas interpretimit të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar², konsiderohet si çasti i lidhjes së kontratës është momenti kur propozuesit i ka mbërritur përgjigja për pranimin e propozimit nga pala tjetër. Rezulton e faktuar dhe provuar që OSSH sh.a. ka instaluar sistemin e matjes dhe së bashku me FTL sh.a. kanë vijuar pranimin në rrjet të energjisë elektrike, i cili tregon qartë që ajo ka pranuar këtë propozim dhe ka qenë dakord me vazhdimin e këtij bashkëpunimi, me kushtet e mësipërme, në të kundërt do të kishte ndërprerë kryerjen e shërbimeve, pasi këta prodhues janë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në nivelin 35 kV.

- Sa më sipër, shoqëritë FTL sh.a. dhe OSSH sh.a. duhet të marrin masat për rakordimin dhe njohjen e kompensimit të energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria "NTSP" sh.p.k., për periudhën 28.7.2022 deri më 8.11.2022. Ky kompensim duhet të kryet me çmimin e energjisë elektrike të miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 166, datë 28.6.2022 "Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2 mw për vitin 2022".

- Në vijim, ERE nëpërmjet shkresës me nr. 1919/10 prot., datë 23.11.2023 i kërkoi shoqërisë OST sh.a., të përcjell të dhëna nëse për periudhën 28.7.2022 deri më 8.11.2022, shoqëritë "Tren Sun System" sh.p.k., "Sun Beat System" sh.p.k., "NTSP" sh.p.k., dhe "Korça Photovoltaic Park" sh.p.k. kanë pasur kontrata të lidhura dhe të deklaruara në OST sh.a. për shitjen e energjisë elektrike të prodhuar në tregun e parregulluar.

- Shoqëria OST sh.a. me shkresën nr. 5980 prot., të protokolluar në ERE me nr. 1919/15 prot., bën me dije si vijon: Për sa u përket deklarimeve të njoftimit të kontratave për periudhën: 28.7.2022 deri më 8.11.2022, kompanitë: "Tren Sun System" sh.p.k., "Sun Beat System" sh.p.k., NTS sh.p.k. dhe "Korça Photovoltaic Park" sh.p.k., nuk kanë deklaruar njoftim kontrate në OST sh.a. lidhur me transaksionet dypalëshe për shitblerje në tregun me shumicë të energjisë elektrike. Këto subjekte prodhuese janë regjistruar si palë përgjegjëse balancuese, pjesë e një grupi balancues konform akteve rregullatore në fuqi dhe kanë deklaruar njoftimin e parë të kontratës për shitblerje të energjisë së prodhuar nga impiantet fotovoltaike në tregun me shumicë të energjisë elektrike më datë 9.11.2022.

- Ky vlerësim i përcjellë nga OST sh.a. është një element shtesë i cili provon se përgjatë periudhës 28.7.2022 deri më 8.11.2022, shoqëria "NTSP" sh.p.k., nuk ka pasur kontrata të tjera për të lëvruar energjinë e prodhuar përgjatë kësaj periudhe. Kjo energji është prodhuar dhe lëvruar në rrjetin e shpërndarjes ku dhe janë të lidhura këto subjekte.

- Në VKM-në nr. 456/2022, në nenin 12, përcaktohet detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë për shoqërinë FTL sh.a. Gjithashtu, përcaktohet se shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, deri në krijimin e operatorit të energjisë së rinovueshme dhe krijimin e tregut të ditës në avancë, do ta tregtojë këtë energji për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, me të njëjtin çmim me të cilin e blen këtë energji nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, deri në përfundimin e kontratave të shitblerjes së energjisë.

¹ Neni 80, format e veprimit juridik: veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit. Shkresa mund të jetë e thjeshtë ose akt noterial.

² (Ndryshuar me ligjet nr. 8536, datë 18.10.1999, nr. 8781, datë 3.5.2001, nr. 17/2012, datë 16.2.2012, nr. 121/2013, datë 18.4.2013, nr. 113/2016, datë 3.11.2016.)

- Energjia elektrike e prodhuar nga shoqëria "NTSP" sh.p.k., e lëvruar në rrjetin e shpërndarjes në të cilin janë lidhur dhe operojnë këto shoqëri dhe për të cilën nuk evidentohen transaksione me furnizues të tjerë të energjisë elektrike për periudhën 28.7.2022 deri më 8.11.2022, sikurse është bërë me dije nga shoqëria OST sh.a. është në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022.

- Për sa parashtruar, vlerësojmë se shoqëritë FTL sh.a., OSSH sh.a. dhe shoqëria "NTSP" sh.p.k., duhet të marrin masa për të rakorduar ndërmjet tyre sasinë e energjisë elektrike të evidentuar në matës për periudhën 28.7.2022 deri më 8.11.2022, duke marrë në konsideratë procesverbalet përkatës të instalimit të sistemit të matjes. Në të njëjtën kohë, shoqëria FTL sh.a. duhet të rakordojë bilancin energjetik me OSSH sh.a. për këtë sasi energjie në përputhje me përcaktimin e mësipërm të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shoqëria OSSH sh.a., dhe shoqëria "NTSP" sh.p.k., të marrin masa për të evidentuar sasinë e energjisë elektrike në sistemin matës të prodhuar për periudhën 28.7.2022 deri më 8.11.2022.

2. Shoqëritë FTL sh.a. dhe "NTSP" sh.p.k., të marrin masa për të rakorduar ndërmjet tyre sasinë e energjisë elektrike për periudhën 28.7.2022 deri më 8.11.2022.

3. Shoqëritë FTL sh.a. dhe OSSH sh.a. të realizojnë rakordimet përkatëse në bilancin energjetik vjetor të vitit në vijim për këtë sasi të energjisë elektrike të prodhuar.

4. Shoqëria FTL sh.a. të njohë dhe të paguajë shoqërinë "NTSP" sh.p.k., për sasinë e energjisë elektrike të prodhuar të evidentuar në sistemin matës, të rakorduar dhe të lëvruar për shoqërinë OSSH sh.a., sipas çmimit të miratuar nga ERE me vendimin nr. 166, datë 28.6.2022.

5. Palët subjekt i mosmarrëveshjes respektivisht, OSSH sh.a., FTL sh.a. dhe "NTSP" sh.p.k., të marrin masa për zbatimin e pikave 1, 2, 3 dhe 4 brenda datës 31 mars 2024 dhe të raportojnë në ERE brenda 30 ditëve për ecurinë e zbatimit të detyrimeve sipas këtij vendimi.

6. Ky vendim është i vlefshëm vetëm për këtë rast të shqyrtuar.

7. Grupi i punës te njoftojë shoqëritë "NTSP" sh.p.k., FTL sh.a. dhe OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola Sadushi